

V E N D I M
Nr.461, datë 22.7.1998

**PËR REGJISTRIN QË MBAN PUNËDHËNËSI PËR AKSIDENTET NË PUNË DHE
PËR SËMUNDJET PROFESIONALE**

Në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr.7691, datë 12.7.1995 "Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punëdhënësi ose personi përgjegjës i ngarkuar prej tij, duhet të mbajë në ndërmarrje regjistrin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale. Në këtë regjistër duhet të regjistrohen të gjitha aksidentet dhe gati-aksidentet, që ndodhin në ndërmarrje dhe të gjitha rastet e sëmundjeve profesionale.

2. Regjistri duhet të përmbajë këto elemente:

- a) emrin, mbiemrin e të punësuarit;
- b) datëlindjen;
- c) profesionin;
- d) repartin ku ndodh aksidenti;

e) datën e aksidentimit;

f) të gjitha aksidentet në punë, me pasojë vdekjen;

g) të gjitha aksidentet në punë, të cilat kanë sjellë humbje të aftësisë për punë të punëmarrësit;

h) të gjitha ndodhitë në të cilat mund të ishte shkaktuar aksidenti (gati-aksidenti);

1) pjesa e dëmtuar e trupit;

j) diagnoza e sëmundjes profesionale;

k) data e diagnostikimit;

1) faktorët shkaktues të sëmundjes në mjediset e punës;

m) ditët e paaftësisë për punë për shkak të aksidentit ose sëmundjes profesionale;

n) masat që duhen marrë për të ardhmen.

3. Në rastet e dëmtimit të më shumë se një punëmarrësi, regjistrimi të bëhet për secilin punëmarrës të dëmtuar, në të njëjtin aksident.

4. Çdo fletë e regjistrit, përpara përdorimit të tij, të nënshkruhet nga inspektori i punës dhe duhet të ruhet nga punëdhënësi për një periudhë 5-vjeçare. Pas kësaj periudhe këto regjistra arkivohen pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

5. Edhe në rastet e mbylljes së veprimtarisë para afatit 5-vjeçar dhe kryesisht në çastin e mbylljes së veprimtarisë, punëdhënësi është i detyruar t'i arshivojë regjistrat pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

6. Punëdhënësi është i detyruar të vërë regjistrin në dispozicion të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, sa herë që do t'i kërkohet.

7. Regjistri-tip hartohet nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

